



JP KOMUNALNE DJELATNOSTI - ULCINJ
NP VEPRIMTARITË KOMUNALE - ULQIN

PROGRAMI I KRYERJES SË VEPRIMTARIVE KOMUNALE NË ZONËN E TË MIRAVE DETARE për vitin 2019



Dhjetor, 2018.

HYRJE

Me Ligjin për veprimtari komunale ("Fl. zyrtare e MZ", numër 55/2016, 074/16 dhe 002/18), me nenin 30, është definuar kryerja e veprimtarive komunale në të mirën e mbrojtur natyrore edhe në zonën e të mirave detare. Me vendimin për rendin komunal të Komunës së Ulqinit, veprimtaritë komunale janë definuar si mirëmbajtje e pastërtisë në qytete dhe vendbanime të tjera, rregullim i hapësirave të gjelbra publike dhe larje e rrugëve.

Kryerja e veprimtarive komunale në pajtim me Ligjin kryhet në pajtim me nenin 14 dhe 15 të Ligjit për veprimtari komunale dhe në bazë të kontratës në mes njërive të vetëqeverisjes lokale dhe N.P. Të Mirat Detare të Malit të Zi.

Kryerjen e veprimtarive komunale në zonën e të mirave detare, Komuna e Ulqinit ia besoi N.P. "Veprimtaritë Komunale" Ulqin themeluese e të cilës është.

N.P. "Veprimtaritë Komunale" Ulqin në periudhën e kaluar në zonën e të mirave detare ka mirëmbajtur rendin komunal, përmes punëve: pastrimi dhe larja e hapësirave të pa-qiramarra, grumbullimin, transportin dhe deponimin e mbeturinave, gjelbërimit dhe mirëmbajtjen e hapësirave të gjelbra, mirëmbajtjen dhe rregullimin e ndriçimit publik.

Duke marrë parasysh rëndësinë e mirëmbajtjes së rendit publik, higjienës publike dhe infrastrukturës komunale në këtë zonë, për qytetarët dhe mysafirët e Ulqinit, por edhe për ekonominë turistike, ndërmarrja ka synim elementar mirëmbajtjen e cilësisë së lartë të ofrimit të shërbimeve në këtë zonë, veçanërisht në periudhën e sezonit turistik 2019.

Duke analizuar rezultatet e punës nga viti i kaluar, identifikuam drejtimet e zgjidhjes së problemeve dhe detyrave aktuale të cilat duhet të realizohen.

1) Rritja e konsiderueshme e deponimit ilegal të mbeturinave të cilat sipas karakteristikave nuk është mbeturinë komunale në tërë hapësirën të cilën e menaxhon NP "Të Mirat Detare".

2) Ngarkesa e vazhdueshme gjatë aktivitetit të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave nga kjo zonë, në veçanti gjatë komunikacionit të rënduar në rrugët lidhëse, që rrit periudhën e angazhimit të makinave dhe ekuipazhit.

3. Mungesa e theksuar e kulturës gjatë hedhjes së mbeturinave gjatë tërë ditës, me papërgjegjësi të theksuar të objekteve tregtare dhe të furnizuesve të tyre rreth kohës dhe mënyrës së deponimit të mbeturinave.

4. Obligimet e parregulluara kontraktuese me themeluesin, për kryerjen e punimeve në këtë zonë, me zvogëlim konstant të mjeteve financiare për këto punë, edhe pse me ligj është definuar që nga 50% të mjeteve të cilat NP "Të Mirat Detare" i paguan, pjesa më e madhe duhet të investohen në mirëmbajtjen e rendit komunal në këtë zonë.

5. Marrëdhënia e papërcaktuar e shfrytëzuesve të shërbimeve si qiramarrës ndaj ndërmarrjes, në zonën e të mirave detare, si dhe qasja josistematike e Njësisë së

Vetëqeverisjes lokale dhe ndërmarrjes rreth obligimit të nënshkrimit të kontratës për transportin e mbeturinave komunale, si dhe shmangja e dedikuar e pagesës së obligimeve ndaj ndërmarrjes.

Këto që u përmendën kërkojnë angazhim më të madh të fuqisë punëtore dhe teknikës, pra edhe rritjen e shpenzimeve në krahasim me vitet paraprake.

NP Veprimtaritë Komunale Ulqin kryen veprimtarinë e parashikuar me ligj dhe aktet nënligjore dhe atë:

Punët e mirëmbajtjes së pastërtisë në hapësirat publike, janë të rregulluara me këto akte ligjore dhe nënligjore:

- ✓ *Ligji për vetëqeverisje lokale (Fl. zyrtare e RMZ 42/03),*
- ✓ *Zakon për veprimtari komunale (Fl. zyrtare e RMZ 12/95),*
- ✓ *Zakon për mbrojtjen dhe mirëqenien e kafshëve,*
- ✓ *Vendimi për formimin e NP Veprimtaritë komunale – Ulqin*
- ✓ *Vendimi për rendin komunal të Komunës së Ulqinit (Fl. zyrtare e RMZ Dispozitat komunale)*
- ✓ *Vendimi për mënyrën e përdorimit dhe mirëmbajtjes së tregjeve (Fl. zyrtare e MZ, Dispozitat komunale nr. 4/2013),*
- ✓ *Vendimi për rrugët komunale dhe të pakategorizuara (Fl. zyrtare e MZ, Dispozitat e Komunës, nr. 09/2009),*
- ✓ *Statuti i NP »Veprimtaritë komunale« - Ulqin*

Neni 45 i Vendimit për rendin komunal të Komunës së Ulqinit thotë:

Mirëmbajtja e pastërtisë në aspektin e këtij vendim është:

- ✓ *Grumbullimi, tjetërsimi i deponimi i mbeturinave komunale dhe mbeturinave tjera artificiale (mbeturina ndërtimore, të automjeteve dhe të ngjashme) nga hapësirat publike dhe private*
- ✓ *Pastrimi dhe larja e hapësirave publike*
- ✓ *Rregullimi dhe mirëmbajtja e parqeve, hapësirave të gjelbra publike dhe rekreative: mbjellja e pemëve, barit dhe bimësisë tjetër, kositja e barit dhe krasitja e pemëve, mirëmbajtja, furnizimi dhe përtëritja e materialit bimor,*
- ✓ *Grumbullimi i kufomave të kafshëve të ngordhura nga hapësirat publike dhe heqja e tyre, si dhe heqja e automjeteve të rrënuara dhe të lëshuara nga hapësirat publike.*

Si hapësira publike nënkuptohen: rrugët, udhët, trotualet për këmbësor dhe shtigjet për biçikleta, sheshet, mbikalimet dhe nënkalimet, shkallët të cilët lidhin hapësirat e komunikacionit publik, taksi stacionet dhe ndalesat, parkingjet, shëtitorët, lëndinat, gjelbërimi përgjatë rrugëve, hapësirat rreth ndërtesave banuese, këndet publike të lojërave për fëmijë, parqet dhe park pyjet, hapësirat e gjelbra dhe plazhet, molet dhe brigjet e rregulluara.

LËNDA E OFERTËS

Lënda e ofertës është mirëmbajtja e pastërtisë në zonën e Të mirave detare në Komunë të Ulqinit e cila përfshinë këto lokalitete:

- *Mirëmbajtja e pastërtisë përmes pastrimit dhe ripastrimit manual dhe mekanik*
- *Larja e hapësirave*
- *Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave*
- *Mirëmbajtja e gjelbërimit dhe sanitimi ekologjik*
- *Mirëmbajtja e ndriçimit publik*

Oferta përfshinë këto lokacione:

- *Rruga Detarët e Ulqinit – Arnold von Harf,*
- *Ura Port Milena – rruga e plazhit Majami*
- *Ura Teuta – Hotel Karisma*
- *Hapësira para restoranteve në Bunë, parkingu para urës dhe rruga nga parkingu deri tek porta e urës*
- *Udhëkryqi nga kthesa në Adë deri tek Ura,*
- *mirëmbajtja e Parkut të Hollegros*
- *Mirëmbajtja e vazove prej betonit,*
- *Transporti i mbeturinave nga plazhet e parregulluara,*
- *Mirëmbajtja e ndriçimit publik,*
- *Mirëmbajtja e pistës së këmbësorve përgjatë bregut deri në molën e Plazhit të madh.*

Vërejtje: Të gjithë rrugët dytësore të cilët çojnë nga magjistranja kryesore deri në urës Teuta deri tek kthesa në Adë të Bunës (ana e djathtë) nuk janë të përfshira me këtë program sepse nga Sekretariati kompetent nuk morëm vendimin për mirëmbajtjen e higjienës publike në këto akse rrugore. Bëhet fjalë për rrugë dytësore të cilët për nga gjatësia nuk janë të papërfillshme sepse janë më të ngarkuara gjatë sezonit turistik.

Bilanci i shërbimeve për punët e lartëpërmendura bëhet në bazë të çmimit të kryerjes së shërbimeve sipas çmimoreve të shërbimeve të ndërmarrjes.

Punët e paplanifikuara, nëse shfaqet nevoja për ndërmarrjen e aktiviteteve të duhura, do të faturohen si punë shtesë të paparashikuara në bazë të çmimit nga kjo ofertë, ndërsa për transportin dhe deponimin e materialeve ndërtimore dhe mbeturinave inerte në bazë të çmimoreve të kësaj ndërmarrje në bazë të vëllimit të punës, fuqisë së nevojshme punëtore dhe makinerisë së nevojshme.

1. MIRËMBAJTJA E PASTËRTISË NË ZONËN E TË MIRAVE DETARE

1.1. Pastrimi me dhe pa fshesë (me dorë dhe makinë) i hapësirave publike

Përfshinë punët e pastrimit të sipërfaqeve në zonën e të mirave detare në komunë të Ulqinit

Rajoni	Njësia matëse	Sipërf.	Çmimi	Vlera në €
Plazhi i Vogël Rruga Detarët e Ulqinit – Rruga Arnold von Harf	m ²	16286	0,0049	79,80
Plazhi i Madh Ura Teuta – Kthesa për në Adë	m ²	14833	0,0049	72,68
Buna Kthesa për në Adë deri tek parkingu	m ²	6000	0,0049	29,40
	Gjithsej:	37.119		181,88

Shuma prej 181,88 € paraqet çmimin ditor të pastrimit me dhe pa fshesë të hapësirave publike

1.1 Ripastrimi i hapësirave publike

Përfshinë punët e ripastrimit të rrugëve në zonën e të mirave detare në komunë të Ulqinit

Rajoni	Njësia matëse	Sipërf.	Çmimi	Vlera në €
Plazhi i Vogël Rruga Detarët e Ulqinit – Rruga Arnold von Harf	m ²	22800	0,0018	41,04
Plazhi i Madh Ura Teuta – Kthesa për në Adë	m ²	20766	0,0018	37,37
Buna Kthesa për në Adë deri tek parkingu	m ²	8400	0,0018	15,12
	Gjithsej:	51.966		93,53

Shuma prej 93,53 € paraqet çmimin ditor të ripastrimit të rrugëve

Java e punës në sektorin Pastrimi është 6 ditë, gjegjësisht nga e Hëna në të Shtunën. Në bazë të të dhënave të lartpërmendura fitojmë:

VEPRIMTARIA	Çmimi / ditë	Ditë pune	Vlera në €
Pastrimi me dorë	181,88	325	59.111,00€
Ripastrimi	93,53	325	30.397,25 €
Gjithsej			89.508,25 €

1.3. Transporti i mbeturinave nga sipërfaqet e parregulluara (plazheve) me kontejnerë 1,1 m³

Llogaritjen e transportit të mbeturinave e kemi bërë në bazë të numrit të kontejnerëve sipas këtyre treguesve:

- Numri i kontejnerëve të vendosur ose të nevojshëm
- Numri i ditëve në vit në të cilat kryhet transporti
- Numri i turave në ditë

1.4. Mbledhja dhe transporti i mbeturinave nga hapësirat publike nga enët prej betonit me vëllim 0,1 m³

Rajoni	Nr. i enëve	Verës	Turë/ditë	Çmimi	Gjithsej në EUR
Detarët e Ulqinit	40	120	2	3,06	29.376,00
Arnold von Harf	7	120	2	3,06	5.140,00
Plazhi i Madh	4	120	2	3,06	2.937,60
GJITHSEJ	37.453,60				

Në bazë të lartpërmendurave kemi:

VENDBA.	Kont ejn.	m ³	Ditë gjithsej	Ditë verës	Tura në ditë	Ditë dimr.	Tura në ditë	Gjithsej kont.	Çmimi / kont.	Gjithsej
Plazhet e parregulluara	5	1.1	36	36	1	0	0	180	30,60	5.508,00

2.LARJA E RRUGËVE

Përfshinë larjen e rrugëve me cisternë dhe vrull si dhe heqjen e mbeturinave të cilat nuk mund të hiqen me ujin e vrullshëm me presion të caktuar.

Në mënyrë që të arrihet niveli i kënaqshëm i pastërtisë nevojitet që për këto rrugë të kryhet larja nga muaji maj deri në muajin shtator, gjegjësisht gjithsej 153 ditë.

Shëtitorja e Detarëve të Ulqinit - 8.151 m²

Shëtitorja në drejtim të hotelit Albatros, rruga Arnold von Harf 6.026 m²

Shëtitorja Plazhi i madh nga Port Milena deri tek ura Teuta 6.352 m²

Rruga – nga udhëkryqi për në Adë deri tek Ura (me makinë) 7.038 m²

Rajoni	m ²	ditë	norma e larjes / m ²	Nr. i vepri meve	Tura / ditë	Çmimi i i turës	Gjithsej
1. Nga Kalaja deri tek ish hoteli Galeb (me dorë)	8.151	153	3500	2	2,50	50,00	38.250,00
2. Nga ish hoteli Galeb deri në Albatros (me makinë)	6.026	153	5500	1	1,00	50,00	7.650,00
3. Plazhi i madh – Nga Port Milena deri tek hoteli Belvi (me makinë)	6.352	153	5500	1	1,00	50,00	7.650,00
4. Rruga - (nga udhëkryqi për në Adë deri tek Ura) me makinë	7.038	12	5500	1	2,00	50,00	1.200,00
Gjithsej:							54.750,00 €

3. MIRËMBAJTJA E GJELBRIMIT DHE SANIMI EKOLOGJIK

3.1 Mirëmbajtja e parkut Hollegro

Lloji i shërbimit	Copë	Nr. i veprimeve	Sasia e përgjithshme	Çmimi	Vlera në €
Kositja e hapës. të rreg.	1961 m ²	27	52.947	0,0310	1.641,36
Ujitja e barit	1961	45	88.635	0,036	3.176,82
Blerja e luleve sezonale	2.000	1	2.000	0,50	1.000,00
Mbjellja e luleve sezon.	2.000	1	2.000	0,50	1.000,00
Ujitja e luleve sezon.	2.000	45	90.000	0,094	8.460,00
Mihja e luleve sezonale	2.000	6	12.000	0,20	2.400,00
Të ushqyerit me pleh mineral	2.000	2	4.000	0,062	248,00
Gjithsej:					17.926,18 €

3.2 Mirëmbajtja e vazove prej betonit

Lloji i shërbimit	Copë	Numri i veprimeve	Sasia e përgjithshme	Çmimi	Vlera në €
Blerja e humusit	45	1	45	7,00	315,00
Blerja e luleve sezonale	90	1	90	7,00	630,00
Mbjellja e luleve sezonale	90	1	90	1,00	90,00
Ujitja e luleve sezonale	90	45	4.050	0,235	951,75
Të ushqyerit me pleh mineral	90	2	180	0,062	11,16
Gjithsej:					1.997,91 €

3.3 Sanimi ekologjik

Për nevojat e mirëmbajtjes, sipas normës, është paraparë kositja, krasitja, grumbullimi dhe transporti i materialit të deponuar sipas këtij specifikimi.

- Rruga - (nga hoteli Galeb deri tek hoteli Albatros)
- Rruga - (nga udhëkryqi për në Adë deri tek Ura Teuta)
- Pista e këmbësorëve – (nga rruga Arnold von Harf deri tek Molja e Madhe në Plazh të Madhe).

Rruga - (nga hoteli Galeb deri tek hoteli Albatros)

Shkëmesja 970 m² x 0,416024 € = 403,52 €

Kositja 970 m² x 0.031612 € = 30,66€

Rruga - (nga udhëkryqi për në Adë deri tek Ura)

Shkëmesja 2346 m² x 0.416024 € = 975,93 €
 Kositja 2346 m² x 0.031612 € = 74,15 €

Pista e këmbësorëve – (nga rruga Arnold von Harf deri tek Molja e Madhe në Plazh të Madhe).

Shkmesja 2500m x 1,00 € = 2.500,00 €

Për punimet e lartpërmendura propozojmë që rrugët e lartpërmendura duhet të mirëmbahen në këtë mënyrë:

	Shkëmesja	Kositja
Rruga - (nga hoteli Galeb deri tek hoteli Albatros)	2 herë	8 herë
Rruga - (nga udhëkryqi për në Adë deri tek Ura)	2 herë	4 herë
▪ Pista e këmbësorëve	2 herë	

SHPENZIMET PËR SHKMESJE:

Rajoni	Çmimi	Gjithsej
Rruga Arnold von Harf	2 403,52	807,04
Rruga - (kthesa për Adë deri tek ura Teuta)	2 975,93	1.951,86
Pista e këmbësorve	2 2.500,00	5.000,00
GJITHSEJ		7.758,90

SHPENZIMET PËR KOSITJE:

Rajoni	Çmimi	Gjithsej
Rruga Arnold von Harf	8 30,66	245,28
Rruga - (kthesa për Adë deri tek ura Teuta)	4 74,15	296,60
GJITHSEJ		541,88

Përmbledhja	Gjithsej
Mirëmbajtja e parkut tek Hollegroja	17.926,18
Mirëmbajtja e vazove prej betonit	1.997,91

Sanimi ekologjik	8.300,78
GJITHSEJ	28.224,87 €

4. MIRËMBAJTJA E NDRIÇIMIT PUBLIK

Specifikimi teknik

Zëvendësimi i poçave të djegur elektrik për copë përbëhet nga:

Heqja, demontimi i poçit të djegur elektrik dhe montimi i të riut.

Përfshinë zëvendësimin e poçave elektrik, xhamave mbrojtës, adapterëve, fasungëve, siguresave, kontaktorëve, fotoreleve, terminaleve, kablllove të prishura dhe vendosja e lidhjeve kablllore.

Rrugët:

- Rruga e Detarëve të Ulqinit,
- Rruga Arnold von Harf
- Në rrugën tek Port Milena

Gjithsej 142 shtylla.

Çmimi i mirëmbajtjes për një vend të ndriçimit është 9,00 eur në muaj.

Gjithsej shtylla	Numri i punëve	Çmimi	Gjithsej
142	12	9,00	15.336

Në bazë të para-faturës për mirëmbajtjen e ndriçimit publik për vitin vijues janë llogaritur shpenzimet në shumën prej **15.336 €**.

PËRMBLEDHJA E SHPENZIMEVE

VEPRIMTARIA KOMUNALE	VLERA NË €
Pastrimi me dorë dhe mekanik i hapësirave publike	59.111,00
Ripastrimi i hapësirave publike	30.397,25
Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga hapësirat publike	5.508,00

Grumbullimi dhe transporti i mbeturinave nga enët prej betonit me vëllim 0,1 m³	37.453,60
Larja e rrugëve	54.750,00
Gjelbërimi dhe sanimi ekologjik	28.224,87
Mirëmbajtja e ndriçimit publik	15.336,00
Gjithsej në €:	230.780,72

Vërejtjet:

Shpenzimet e përmendura të kryerjes së veprimtarive komunale në zonën e të Mirave detare kanë të bëjnë me mirëmbajtjen e rregullt të hapësirave publike dhe aktiviteteve të grumbullimit dhe transportit të mbeturinave, mirëmbajtjen e gjelbërimit dhe ndriçimit publik, dhe të njëjtat nuk përfshijnë aktivitetin e sanimit të deponive të egra ekzistuese apo të reja. Vëllimi dhe sipërfaqja e deponive të egra ekzistuese janë të pasqyruara në Planin Lokal të Menaxhimit të Mbeturinave në Komunë të Ulqinit.

Shpenzimet e planifikuara për kryerjen e veprimtarive komunale nuk janë të precizuara me buxhetin e Komunës së Ulqinit për vitin 2019, dhe të njëjtat duhet të definojnë me kontratën që Komuna e Ulqinit dhe ndërmarrjet në bazë të të ardhurave nga NP Të Mirat Detare të Malit të Zi, në vlerën e shpenzimeve reale të mirëmbajtjes së kësaj zone. Praktika e cila u jetësua në vitet e kaluara duhet të lihet pas, sepse në mënyrë të drejtpërdrejtë rrezikon funksionimin e ndërmarrjes për këto veprimtari dhe paraqet ngarkesë, e cila si pasojë ka problemet e shumta sa i përket cilësisë së mirëmbajtjes së kësaj zone.

UD i Drejtorit

Skender Kaleziqi

SHËNIMET, VËREJTJET, PROPOZIMET